



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2015 prot.

Shkodër, më 30.01. 2025

VENDIM

Nr. 10 datë 30.01.2025

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, TË PRONAVE
ISH REPARTI USHTARAK BERDICË, DHE PASURITË NEN PËRGJEGJËSI TË
DPSHTRR NGA PRONA SHTETËRORE, TEK BASHKIA SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.01.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, te ligjit Nr. 139, datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; nenit 3, nenit 5, nenit 17 të ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM Nr.500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003, “Për menyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike, Shkresës së Ministrinë se Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me lëndë “Mbi realizimin e detyrave të Mikroqendrës Ushqimore në kuadër të projektit “Qëndrueshmëria ndaj Klimes dhe Zhvillimit të Bujqësisë”, Nr.8323/1 prot., datë 23.12.2024, dhe sipas dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pronave me këto të dhëna:
 - **Ish-Reparti Usharak Berdicë i ndodhur në Zonen Kadastrale Nr.1158 Nj.Administrative Berdicë, Bashkia Shkodër, e cila është nën përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.**
 - **Pasuria me nr.10/127 e ndodhur në Zonën Kadastrale 8592 Shkodër me sipërfaqe prej 23149 m² e cila është në përgjegjësi administrimi të Repartit të FNSH Shkodër e pajisur me dokument pronësie me nr 273, datë 19.12.2003.**

- Pasuritë e ndodhura në Zonën Kadastrale 8591 Shkodër të cilat janë nën përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit dhe pozicionohen në numrat e pasurive me Nr. 4/53; Nr. 4/222; Nr. 4/223; Nr. 4/296; Nr. 4/130; Nr.4/315; Nr. 4/652.
- 2. Fusha e përdorimit për këto pasuri që kërkohet të tranferohen, do të jetë prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve sipas parashikimeve të ligjeve në fuqi.
- 3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e fushës së përdorimit të pasurive të sipërcituara duke bashkërenduar punën me Ministrinë përgjegjëse.
- 4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24
Vota Kundër 1
Vota Abstenim 8
Zbardhur me datë 31.01.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

